

## SYLLABUS: Buxhetimi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Buxhetimi
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obliguar
Viti i studimeve:	Viti II-të, semestri III-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Alban Elshani
Detajet kontaktuese:	Alban.elshani@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda përfshinë buxhetin e sektorit publik dhe buxhetin e sektorit privat.</p> <p>Procesi buxhetor është pjesa më e rëndësishme dhe themelore e procesit të politikave publike dhe qeverisjes demokratike. Buxheti ndikon në gjendjen financiare të subjekteve qeveritare, përcakton dhe priorizon politikat e ndryshme substanciale që do të zbatohen nga entitetet qeveritare, shpërndanë burime të pakta publike dhe shpërndan barrën e pagesës për mallrat dhe shërbimet publike.</p> <p>Në pjesën e buxhetimit të sektorit privat, lënda do të përfshijë elemnetet e buxhetit, tipet e buxhetit, master buxhetin, projektimin e pasqyrave financiare si dhe planifikimin e kostove ne përgatitjen e buxhetit.</p> <p>Studentët do të futen në procesin e buxhetit publik si dhe atij privatdhe në teorinë, praktikën dhe metodologjinë kryesore të buxhetit. Do të diskutohen dallimet midis buxhetit në sektorin publik dhe privat. Do të rishikohet struktura dhe procesi i buxhetit dhe pjesëmarrësve në proces.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është të kuptohet kompleksiteti i procesit buxhetor, rëndësia e menaxhimit të mjeteve buxhetore dhe proceset për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e buxhetimit publik.</p> <p>Sqarimi i rolit të buxhetit në marrjen e vendimeve, përshkrimi i hapave në përgatitjen e master buxhetit. Përgatitja e buxhetit operacional, cash buxhetit, projektimi i pasqyrave financiare, buxheti fleksibil dhe buxheti i kapitalit. Në përgatitjen e buxhetit, studentët do të përdorin veglat kompjuterike.</p>

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, një student duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kuptojë procesin buxhetor dhe kushtet kyçe të procesit;</li> <li>✓ Identifikojë qëllimet e ndryshme publike dhe shpenzimet e lidhura me to;</li> <li>✓ Kuptojë tatimet si burim kryesor i të hyrave publike;</li> <li>✓ Kuptojë menaxhimin financave publike;</li> <li>✓ Sqaron rolin e buxhetimit</li> <li>✓ Projektton pasqyrat financiare</li> <li>✓ Parapërgatit buxhetin fleksibil si një element i adaptimit të situatave të papritura në biznes.</li> </ul>
---	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiime, seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj	3	2	6
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Në kuadër të këtij kursi, orët tjera shpesh të ngarkesës mësimore studentët duhet t'i kalojnë në studime të pavarura. Studentët inkurajohen që të përgatisin dhe të prezantojnë punime seminarike.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë semestrit, nota përfundimtare në këtë kurs do të jetë: Pjesëmarrja aktive e studentit 5%; Përgatitja dhe prezantimi i seminarit 15%;

	Vlerësimi i parë 40%; Vlerësimi i dytë 40%; Gjithsej 100%. Kalueshmeria 51%
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bland, Robert L. 2013. A Budgeting Guide for Local Government. 3rd edition (must be this edition). Washington, DC: International City-County Management Association. ISBN: 978-0-87326-767-0.</li> <li>2. Kontabiliteti i Menaxhmentit – Prof.Dr. Skender Ahmeti, 2018</li> <li>3. Swain, John W., and B.J. Reed. 2010. Budgeting for Public Managers. Armonk, NY: M.E. Sharpe. ISBN: 978-0-7656-2050-7.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mikesell, J. L. (2016). Fiscal administration: Analysis and applications for the public sector (10th ed.). Boston, MA: Cengage Learning. [ISBN-13: 978-1305953680] (Note: The 9th edition of the text will suffice in lieu of the 10th edition).</li> <li>2. Michel, R.G. (2004). Cost Analysis and Activity-Based Costing for Government (1st ed.). Government Finance Officers Association. [ISBN-13: 978-0891252689]</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Prezentimi i Syllabusit
<b>Java e dytë:</b>	Buxheti publik si instrument financiar
<b>Java e tretë:</b>	Organizatata buxhetore
<b>Java e katërt:</b>	Proceset dhe procedurat buxhetore
<b>Java e pestë:</b>	Planifikimi i buxhetit
<b>Java e gjashtë:</b>	Miratimi dhe ekzekutimi i buxhetit
<b>Java e shtatë:</b>	Testi 1
<b>Java e tetë:</b>	Buxheti kryesor dhe planifikimi i performancës
<b>Java e nëntë:</b>	Buxheti operativ
<b>Java e dhjetë:</b>	Buxheti financiar
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Raporti i performancës së buxhetit statik
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Raporti i performancës së buxhetit fleksibil
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Përlllogaritja standarde dhe shmangiet
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Buxhetimi i kapitalit dhe analiza e investimeve
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi 2

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Pjesëmarrja e studentëve në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Mësimdhënësi duhet të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve gjatë kohës zyrtare si dhe përmes emailit. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën, ti dorëzojnë punimet dhe ti prezantojnë ato.